



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 9.2.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selvije Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliqeviq.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Avni Uka- “Bota Sot”, Gresë Sermaxhaj – “Kosova Sot”, Taulant Osmani-“Rrokum”, Dibran Istrefi- “Klan Kosova”, Florina Merovci-ZPRK, Ardita Sylejmani-RTK, Alma Tafarshiku-EULEX, Sanije Jusufi-“Koha Ditore”, Liridona Xhemajli-“RTV21”, Besarta Maliqi- “Tribuna”, Bekim Kodraliu-OSBE, Gentiana Azemi-praktikante, Prenk Gjetaj-KQPZH, Viskant Jakupi-MPJ/KQPZH dhe Kushtrim Gara-KQPZH.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryesuesja propozoi që në pikën të ndryshme të shqyrtohet shkresa e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, me numër 310, e datës 8.2.2016, që ka të bëjë me Projektligjin për Mjekësinë Ligjore.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.1.2016;

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtura më 20.1.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;

Kryesuesja: E hapi debatin për Projektligjin për Kundërvajtje. Fjalën e pari e merr deputeti Armend Zemaj.

Armend Zemaj fillimisht potencoi rëndësinë që ka ligji dhe përfundimisht me këtë edhe plotësimin e zbrazëtirës që ka ekzistuar deri me tani për sistemin e drejtësisë në vendin tonë. Sipas tij, Projektligji i plotëson kriteret e përgjithshme, por megjithatë janë disa vërejtje parimore për të cilat, tha Zemaj, kërkoj që të bëhet krahasimi me ligjin që ka të bëjë me Infrastrukturën Rrugore dhe të Transportit, sidomos te pjesa e gjobave, ndëshkimeve, deri te dënimet që hyjnë në Kodin Penal.

Në fund, z. Zemaj potencoi se si ligj i plotëson kushtet dhe kriteret dhe duhet dhënë përkrahje në parim dhe nëse shkon në lexim të parë, propozoi që të formohet grupi punues, i cili do të merret me këtë çështje.

Agim Aliu theksoi rëndësinë e këtij ligji për faktin se bëhet për herë të parë, dhe se po plotësohet boshllëku në sistemin e drejtësisë. Ajo që z. Aliu ritheksoi, ishte se deri më tani është punuar me ligje tjera, derisa ky ligj, sipas tij, është ligji yni, i cili në parim është i pranueshëm dhe i plotëson kriteret për të marrë përkrahjen e komisionit. Deputeti Aliu propozoi në fund që të ftohen edhe deputetet tjerë që të bëjmë një ligj të mirë.

Kryesuesja tha se është mirë që kemi një Projektligj si ky në Kuvend dhe pas shqyrtimit në parim nga ana e Kuvendit, do të formohet grupi punues, ku do të ketë bashkëpunim me të gjithë aktorët e fushës përkatëse, dhe do të mundohemi që të bëjmë një ligj efikas dhe të zbatueshëm për qytetaret tanë.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;

Kryesuesja në fjalën e saj sqaroi se grupi punues që është formuar për këtë Projektligj, e ka shqyrtuar Projektligjin dhe pastaj ka sjellë amendamentet në komision të procedohen tutje, duke i dhënë më pas fjalën për më tepër sqarime z. Agim Ademaj, meqë ky ishte edhe kryesues i grupit punues.

Agim Ademaj sqaroi se grupi punues me gjithë aktorët tjerë, përfshirë edhe vet sponsoruesin, kanë punuar rreth këtij Projektligji. Ai theksoi se janë bërë disa amendamente, disa ndërhyrje të cilat nuk e ndryshojnë Projektligjin shumë, dhe me shqyrtimin nen për nen, janë nxjerrë nëntë amendamente, dhe në cilësinë e kryesuesit të grupit punues, i ftoi anëtarët e komisionit që të aprovojnë amendamentet, me qëllim që ligji të procedohet për seancë.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Të ndryshme.

Kryesuesja në piken **të ndryshme**, njoftoi komisionin se është një çështje në Projektligjin për Mjekësinë Ligjore që është sjell nga Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur. Ajo njoftoi se prezent është edhe kryetari i këtij komisioni z. Prenk Gjetaj. Znj. Halimi mëtej sqaroi se Projektligji për Mjekësinë Ligjore ka kaluar nëpër të gjitha komisionet tjera dhe është gati për procedim në Kuvend, mirëpo, çështja ka të bëjë me nenin 15. paragrafi 1.6, dhe për sqarime shtesë ftoi ta marrë fjalën z. Prenk Gjetaj.

Prenk Gjetaj në fjalën e tij sqaroi se nuk ka të bëjë për ndonjë plotësim, por për një sqarim rreth asaj se në Ligjin për Persona të Zhdukur, ka pasur dilema rreth termit **i zhdukur**, i cili term sipas tij edhe ka qene aprovuar nga Kuvendi dhe si i tillë kërkoi në këtë Projektligj, aty ku bëhet fjalë për persona të zhdukur, të jetë **i zhdukur** e jo **i pagjetur**. Ai më tej shtoi se është bërë edhe arsyetimi për këtë çështje dhe besoj se është me vend. Fjalën e tij e përfundoi me shpresën se anëtarët e komisionit këtë çështje do ta adresojnë në Kuvend.

Kryesuesja tha se parashtimi i kërkesës nga ky komision ishte shume i qartë, megjithatë ishte më e arsyeshme që të ftoheni edhe ju dhe të jeni në dijeni për vendimin që do të merret nga ana e komisionit. Kryesuesja theksoi se personalisht e përkrah këtë propozim, por shtoi se për të evituar procedura nëpër komisione tjera, kur dihet se ky propozim nuk ka implikime buxhetore, tha, se nuk kërkohet shqyrtim shtesë nga ana e komisionit për integritet dhe gjithashtu nuk bie ndesh me fushëveprimtarinë e komisionit për komunitete. znj. Halimi propozoi që kjo kërkesë të

dërgohet në Kuvend si amendament, të njoftohen edhe komisionet e përhershme, të cilat janë të obliguara të shqyrtojnë ligjet.

Armend Zemaj kërkoi sqarim nga komisioni, ku thuhet se nëse i referoheni vetëm pjesës që ka të bëjë me persona të zhdukur, mendoj që është në rregull që të jeni pjesë edhe ju si komision qeveritar, ndërsa për pjesën tjetër, nuk mendoj që duhet të përfshiheni. Zemaj kërkoi nga komisioni qeveritar të sqarohen se çka paraqet hendikep nëse në këtë paragraf nuk përmendet Komisioni Qeveritar? Ai gjithashtu tha se çdoherë kur hartohet legjislacion, kemi mëtuar t'i ikim dublifikimeve të emërtimeve ose përzierjes së fushëveprimtarisë që ka të bëjë me komisione tjera, dhe kjo është arsyeja që duhet të sqarohet, duke pyetur se pse komisioni qeveritar mendon që kjo duhet të jetë në këtë amendament dhe se ai tha se personalisht e përkrah këtë kërkesë.

Kushtrim Gara, nga Komisioni Qeveritar, tha se kërkesa ka të bëjë vetëm me nenin 15, paragrafi 1.6, i cili është i vetmi që Agjencinë për Mjekësinë Ligjore e ndërlidh me persona të zhdukur dhe nuk ka asnjë përpjekje që të ketë implikime ose përfshirje në pjesët tjera. Në vazhdim z. Gara potencoi se duke pasur parasysh bazën ligjore dhe ligjin për persona të zhdukur është krijuar një organ qeveritar, i cili koordinon në tërësi aktivitetet mes gjithë aktorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, që janë pjesë e këtij procesi. Ai tha se kërkesa e tyre është që ky nen të riformulohet dhe ky aktivitet që është paraparë të kryhet nga Mjekësia Ligjore dhe të jetë në koordinim me Komisionin Qeveritar.

Armend Zemaj tha se pasi Komisioni Qeveritar të sqarohet sa i përket kërkesës që e kishin parashtruar, ai kërkoi që të saktësohet qartë se ku përfshihet puna dhe kompetenca tyre, dhe se në fund do ta përkrahë këtë propozim.

Kryesuesja në vazhdim lexoi propozimin e Komisionit Qeveritar për persona të zhdukur. Në fund ajo rekomandoi që ky propozim të paraqitet në seancën plenare në formë të amendamentit me sqarimin e bërë dhe pastaj të votohet.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Komisioni pas diskutimeve lidhur me këtë çështje, u pajtua që propozimi i Komisionit Qeveritar për Mjekësinë Ligjore, që ka të bëjë me nenin 15 paragrafi 1.6, i Projektligjit të propozohet për ndryshim gjatë shqyrtimit të dytë të Projektligjit në Kuvend. Në fund të takimit, Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më 16.2.2016, në orën 11:00

Mbledhja përfundoi në orën 11.35

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi

Aneks- Amendamentet e miratuara për Projektligjin nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Amendamenti 1

Në nenin 2, nënparagrafi 1.10, në rreshtin e gjashtë, fjalët “nga neni 265 i Kodit të ose e cila i nënshtrohet sekuestrimit nga neni 267 i Kodit”, **hiqen** dhe zëvendësohen me fjalët: “ose sekuestrimit sipas legjislacionit në fuqi”.

Amendamenti 2

Në nenin 4, nënparagrafi 1.2, në rreshtin e tretë, fjalët: “ në pajtim me nenin 273 të Kodit “ **hiqen** dhe zëvendësohen me fjalët: “sipas legjislacionit në fuqi.”

Në nenin 4, nënparagrafi 1.3, në rreshtin e tretë, fjalët: “në pajtim me nenin 487, paragrafi 3 i Kodit”, **hiqen** dhe zëvendësohen me fjalët: “sipas legjislacionit në fuqi” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 3

Në nenin 11, paragrafi 2, në fund të këtij paragrafi, shtohen fjalët: “Raportimi statistikor duhet të pasqyrojë qartë numrin dhe llojin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

Amendamenti 4

Neni 14, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, pas fjalës ligj, shtohen fjalët: “ **përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale**”.

Amendamenti 5

Neni 15, titulli riformulohet si vijon: “ **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**”.

Amendamenti 6

Neni 17, paragrafi 2, riformulohet si vijon: “2. Në mungesë të kërkesave të qarta në vendimin e Gjykatës kompetente, Agjencia mund të kërkojë sqarime konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Amendamenti 7

Në nenin 19, paragrafi 5, në rreshtin e tretë, fjalët: “**së konfiskuar**”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj. Kurse në rreshtin e shtatë, fjalët: “**obligohet që**”, hiqen dhe zëvendësohet me “**mund**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 8

Neni 26, paragrafi 5, në rreshtin e pestë, fjala **”përgjithshme”**, hiqet dhe zëvendësohet me **”legjislacionit në fuqi”**.

Amendamenti 9

Neni 30, paragrafi 2, riformulohet si vijon: “2. Shitja e pasurisë dhe mjetet nga shitja e pasurisë, sipas legjislacionit aktual në fuqi, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen në pajtim me dispozitat përkatëse të këtij ligji për shitjen dhe mjetet nga shitja e pasurisë”.